



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVO

MINISTRIA E EKONOMISË DHE FINANCAVE - MINISTARSTVO ZA PRIVREDU I FINANSIJE - MINISTRY OF ECONOMY AND FINANCE
ADMINISTRATA TATIMORE E KOSOVËS - PORESKA ADMINISTRACIJA KOSOVA - TAX ADMINISTRATION OF KOSOVO

ADMINISTRATA TATIMORE E KOSOVËS

STATUTI I TATIMPAGUESVE

**Të drejtat dhe obligimet
që duhet t'i dini**

2009
www.atk-ks.org

HYRJE

Qëllimi ynë është të përcaktojmë dhe publikojmë të drejtat dhe obligimet e tatimpaguesve ashtu që tatimpaguesit të kenë besim në drejtësi dhe paanësi të sistemit tatimor por ata gjithashtu duhet të jenë në dijeni për implikimin e mos-përbushjes.

Misioni i Administratës Tatimore të Kosovës është zhvillimi në nivelin më të lartë të përbushjes vullnetare në përputhje me ligjet dhe rregulloret që janë në fuqi e gjithashtu edhe dhënia e shërbimeve profesionale, transparente dhe efektive për komunitetin.

“Statuti i Tatimpaguesve” është përgatitur në atë mënyrë që të jetë një udhëzues i thjeshtë, gjithëpërfshirës dhe sqarues për ndërtimin e marrëdhënieve moderne në mes të autoritetit tatimor dhe tatimpaguesve, bazuar në besim dhe respekt të ndërsjellë .

Shërbimi ynë është e drejta e çdo qytetari.

Sakip Imeri, Zv/Drejtor i ATK-së

Parathënie

"Secili person është i obliguar të paguajë tatimet dhe kontributet e tjera të parapara me ligj"

(Neni 119 i Kushtetutës të Republikës së Kosovës)

"Shpenzimet publike dhe mbledhja e të hyrave publike duhet të bazohen në parimet e llogaridhënies, efektshmërisë, efikasitetit dhe transparencës"

(Neni 120 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës)

Respektimi i ligjit tatimor është përgjegjësi esenciale qytetare.

Në një vend modern nga qytetarët kërkohet pagesa e tatimeve dhe obligimeve të tjera të cilat financojnë programet qeveritare, ofrimin e shërbimeve publike si dhe standardet e larta të arsimimit, mirëqenies, shëndetit, mbështetjes sociale, mbrojtjes, zbatimit të ligjit, dhe infrastrukturës transportuese, këto mund të sigurohen dhe të bëhen të mundshme vetëm me mbledhjen e duhur të tatimeve.

Administrata Tatimore e Kosovës, duke kryer detyrat dhe përkushtimet e saja, vepron me parimet thelbësore ashtu që tatimpaguesit të veprojnë në pajtueshmëri me ligjin kur ata janë të trajtuar me respekt dhe drejtësi dhe kur të kenë marrë të gjitha informatat, këshillë, asistencë dhe shërbime të tjera që atyre u duhen për t'i përmbushur obligimet e tyre.

Statuti i Tatimpaguesve do ju ndihmojë që t'i kuptoni të drejtat dhe obligimet e juaja themelore nën sistemin tatimor dhe gjithashtu sqaron se çfarë mund të prisni nga ne kur merremi me ju

Të drejtat tuaja

01 E drejta e juaj për tu informuar, ndihmuar dhe dëgjuar

Ne do ju trajtojmë juve me mirësjellje dhe konsideratë në çdo kohë dhe në rrethana normale do të mundohemi:

- të ju ndihmojmë që t'i kuptoni dhe t'i përmbushni obligimet e juaja tatimore;
- të ju sqarojmë arsyet për vendimet e marra nga ne, lidhur me punët e juaja;
- të finalizojmë kërkesat për kompensim sa më shpejtë që të jetë e mundur dhe, aty ku lejon ligji, t'u paguajmë interesin në vlerë;
- të kthejmë përgjigje në kërkesat tuaja me shkrim, sa më shpejtë që të jetë e mundur;
- të merremi me kërkesat urgjente sa më shpejtë që të jetë e mundur;
- t'i përgjigjemi telefonatave tuaja shpejtë dhe pa transfere të panevojshme;
- t'i mbajmë kostot tuaja në minimum në përputhje me ligjin;
- t'u japim mundësinë për të pasur këshilltarë të certifikuar ligjor apo tatimor gjatë ndonjë hetimi;
- të ju dërgojmë juve, pas përfundimit të ndonjë kontrolli, procesverbalin relevant apo këshillë të shkruar për rezultatin e kontrolli si dhe arsyet për vendimet që ne kemi marrë;
- kur një vlerësim është bërë, të ju dërgojmë detajet se si është llogaritur vlerësimi.

Ju duhet të dini se ATK-ja do të ju ofrojë udhëzime, duke lëshuar vendime publike dhe individuale për tu shpjeguar se si të interpretoni dhe aplikoni dispozitat e legjislacionit tatimor. Ne do t'i shpërndajmë dhe do t'i bëjmë publike këto vendime .

02 E drejta për të paguar, jo më shumë se shumën korrekte të tatimit

Ne :

- Do të veprojmë me integritet dhe paanësi në të gjitha rastet kur ne merremi me ju, ashtu që ju të paguani vetëm tatimin e duhur legal dhe për të parë se të gjitha kreditë, përfitimet, kompensimet dhe të tjera, janë aplikuar siç duhet.

03 E drejta juaj për siguri

Ne, në rrethana normale do të mundohemi:

- t'u japim juve këshillë, lidhur me implikimet tatimore të veprimeve tuaja;
- t'u njoftojmë sa më shpejtë që të jetë e mundur para kryerjes së ndonjë interviste apo kërkesën për paraqitjen e dokumenteve;
- të ju këshillojmë juve për qëllimin e intervistës dhe kërkesave tona;
- të aranzhojmë një kohë dhe vend të përshtatshëm për intervistë dhe t'u japim kohë juve në përgatitjen e regjistrimeve.

Ju duhet t'a dini se ne mund të kërkojmë nga ju dokumentet e përshkuara dhe shënimet, për të zhvilluar një ekzaminim në kohën dhe vendin e caktuar lidhur me përgjegjësinë tuaj tatimore. .

04 E drejta juaj për intimitet

Ne do të:

- pyesim për ju vetëm për të kontrolluar se ju i keni kryer obligimet tatimore;
- kërkojmë qasje vetëm në informatat relevante për kërkesat tona;
- trajtojmë çdo informatë të siguruar, të marrë apo të mbajtur nga ne, si private.

05 E drejta juaj për Besueshmëri dhe konfidencialitet

Ne:

- nuk do të përdorim e as të përhapim ndonjë informatë personale apo financiare për ju përderisa ju nuk na autorizoni neve me shkrim, për të bërë këtë apo në ato situata kur lejohet me ligj;
- u lejojmë qasje në informatat tuaja personale apo financiare vetëm atyre punëtorëve përbrenda administratës të cilët janë të autorizuar me ligj dhe kërkojnë informatat e juaja personale apo financiare për të administruar programet dhe legjislacionin.

Ju duhet të dini se zyrtarët tatumor duhet të veprojnë dhe të sillen sipas Kodit të Mirësjelljes së ATK-së, shkeljet dhe keqsjelljet mund të hetohen nga Zyra për Standarde Profesionale (PSO).

06 E drejta juaj për ankesë

Ne, në rrethana normale do të mundohemi që:

- plotësisht t’iu sqarojmë të drejtat tuaja për shqyrtim, kundërshtim dhe ankesë, nëse ju jeni të pasigurt për ato, apo keni nevojë për sqarime;
- të rishikojmë rastin tuaj, nëse ju besoni se ne i kemi keqinterpretuar faktet tuaja, se e kemi aplikuar ligjin në mënyrë jo korrekte apo nuk i kemi kryer punët e juaja siç duhet;
- t’iu sigurojmë se shqyrtimi është kryer në mënyrë gjithëpërfshirëse, profesionale dhe të paanshme nga përfaqësuesi i cili nuk është i përfshirë në vendimin origjinal;
- të përcaktojmë kundërshtimin tuaj sa më shpejtë që të jetë e mundur vetëm nëse ne kërkojmë më shumë informata për ta bërë atë, apo nëse çështja është e ndërlikuar në mënyrë të pazakontë;
- t’u japim arsyet nëse kundërshtimi juaj është anuluar plotësisht apo pjesërisht;
- të kërkojmë informata shtesë nga ju, kur është e nevojshme për të zgjidhur çështjen në kontest.

Ju duhet të dini që ekzistojnë procedura gjithëpërfshirëse të pakënaqësive dhe ankesave të hapura për të gjithë tatimpaguesit, dhe ne ju inkurajojmë t’i përdorni, nëse jeni në një mënyrë i pakënaqur me vlerësimin dhe përcaktimin zyrtar të lëshuar nga ATK apo me vendimin zyrtar të lëshuar nga Departamenti i Ankesave.

Përdorimi i procedurave të ankesave të Departamentit të Ankesave të Administratës Tatimore kasnjëherë nuk do t’i paragjykojë të drejtat tuaja për të nisur një ankesë formale, brenda kufizimit kohor statusor, të Bordit të pavarur për Rishqyrtim, kundër vendimit të Departamentit të Ankesave dhe në mënyrë të suksesshëm në gjykatën e juridiksionit kompetent.

Në konteste barra e provës ju bie juve.

Detajet e plota janë në Ligjin Nr.2004/48 mbi “Administratën Tatimore dhe Procedurat” siç është amendamentuar me ligjin Nr.03/L-071

Obligimet tuaja

07 Obligimi juaj që të jeni i ndershëm

Ne presim nga ju, që ju:

- të jepni informata komplete dhe të sakta, ashtu siç kërkohen dhe kur kërkohen;
- të deklaroni të gjitha të ardhurat tuaja të tatueshme në deklaratat tatimore;
- të merrni vetëm zbritjet, kthimet dhe kreditet për të cilat ju keni të drejtë;
- t'u përgjigjeni pyetjeve plotësisht, saktësisht dhe singlerisht;
- të sqaroni faktet dhe rrethanat plotësisht, kur ju kërkoni këshillë tatimore apo kur ju kërkoni vendim individual.

Ju duhet të dini se ne do të vëmë në veprim kërkesën tuaj për rimbursim brenda 60 ditëve të pranimit të kërkesës, dhe do të sigurohemi se detajet e shumës së tatimit që do të rimbursohet të dërgohen me kohë në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave, ose, në rast të pensionit dhe kontributeve, të dërgohen në Trustin e Kursimeve Pensionale.

Nëse rimbursimi nuk aplikohet brenda 60 ditëve, ne do të paguajmë interesin e grumbulluar në shumën që do të rimbursohet.

Norma e interesit është e përshkruar nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave.

08 Obligimi juaj që të jeni bashkëpunues

Ne presim nga ju:

- të bashkëpunoni me zyrtarët tatimor, dhe t'i trajtoni ata me mirësjellje dhe respekt, ashtu siç ne bëjmë kur merremi me ju.

Ju duhet ta dini se, përveç nëse rrethanat e veçanta vendosin ndryshe, zyrtarët tatimor janë të lejuar të kenë qasje në vendet ku personi zhvillon biznesin vetëm kur janë të autorizuar me shkrim nga Drejtori i përgjithshëm i ATK-së për qëllim specifik.

09 Obligimi juaj që t'i paguani tatimet në kohë

Ne presim nga ju:

- që të paguani shumën totale të tatimit në datat e caktuara;
- të paguani shumën totale të ndonjë bilanci të papaguar si rezultat i vlerësimit apo rivlerësimit;
- të na ndihmoni neve, që të zhvillojmë një aranzhim të pagesës së pranuar reciprokisht nëse ju nuk mund të paguani ndonjë bilanc të papaguar plotësisht dhe keni mundësi të arsyeshme për marrjen e fondeve të nevojshme, duke marrë hua apo riaranzhuar punët e juaja financiare;
- të mbani dhe dërgoni në afat të caktuar të gjitha tatimet të mbajtura apo të mbledhura në emër të tjerëve;
- të na këshilloni neve sa më shpejtë që të jetë e mundur, praktikisht nëse ndonjë ndodhi përtej kontrollit tuaj ka ndikuar në mundësinë tuaj për të paguar tatimet në afat të caktuar, ashtu që aranzhimet e duhura mund të ndërmerren për t'iu ndihmuar juve.

Ju duhet të dini se të gjitha tatimet duhet të paguhet në bankë apo në institucion financiar që është e licencuar nga Banka Qendrore e Kosovës (BQK).

Jini të vetëdijshëm se zyrtarët tatimor janë të ndaluar të pranojnë pagesa që i referohen ndonjë tatimi, përveç nëse janë të përcaktuar me shkrim ta bëjnë një gjë të tillë nga Drejtori i Përgjithshëm ATK-së.

Jini të informuar se nga ju kërkohet të paguani apo mbani tatimet për tu paguar brenda datave të specifikuara në legjislacionin relevant, dhe pa u vërejtur apo kërkuar nga Administrata Tatimore.

10 Obligimi juaj të përdorni numrin identifikues fiskal për qëllimet tatimore

Ne presim nga ju të:

- përdorni numrin fiskal, i përcaktuar për ju nga Administrata Tatimore, në të gjitha relacionet, lidhur me vendosjen e obligimeve tatimore;
- nëse jeni person jo rezident, subjekt i tatimit në përputhje me legjislacionin tonë tatimor, të caktoni përfaqësuesin fiskal para se të filloni ndonjë aktivitet ekonomik në Kosovë.

11 Obligimi juaj për të dhënë informata dhe dokumente të sakta në kohë

Ne presim nga ju që të:

- plotësoni saktësisht deklaratat dhe dokumentet përbrenda limitit kohor të përcaktuar;
- të jepni informata të plota dhe të sakta në data të caktuara;
- të keni kujdes të arsyeshëm në përgatitjen e kompensimit të tatimeve, dokumenteve dhe informatave;
- na informoni neve për ndodhitë relevante si, përfshirje, hapje të biznesit, ndërrimin e adresës korrespondente, ndërrimin e vendit të biznesit, si dhe ndërprerjen e biznesit në kohë të caktuar, ashtu që ne të mund të qeverisim legjislacionin tatimor në mënyrë të duhur dhe të efektshme.

Ju duhet të dini se ne do të sigurojmë formular të duhur dhe udhëzime për plotësim, për t'i parashtruar deklaratat tatimore. Nëse e zbuloni ndonjë gabim në deklaratën tuaj tatimore, brenda pesë viteve nga regjistrimi i tyre ju mund të parashtroni një deklaratë korigjuese me obligimet shtesë tatimore apo pagesën e tepërt.

12 Obligimi juaj për të mbajtur shënime

Ne presim nga ju që të:

- mbani shënime të mjaftueshme dhe libra, për të bërë të mundshme kryerjen e obligimeve tuaja tatimore;
- mbani shënime të mjaftueshme dhe libra për periudhën e nevojshme mbajtëse;
- keni kujdes të mjaftueshëm në përgatitjen e shënimeve dhe librave;
- na lejoni neve që të kemi qasje në shënimet dhe librat tuaja, ashtu që ne të mund t'i kontrollojmë obligimet tuaja tatimore.

Ju duhet të dini se personi që zhvillon një biznes duhet të mbajë kontabilitetin me formatin e shkruar apo elektronik dhe librat e caktuara, shënimet dhe inventari i mallrave të përgatiten dhe të mbahen si parashihen në tatimet relevante. Në çdo rast ju do të mbani librat dhe shënimet për një periudhë e të pakën gjashtë viteve pas fundit të periudhës tatimore, të cilave i referohen.

Rreziqet e mos- përmbushjes së obligimeve

13 Nëse ju nuk i përmbushni obligimet tuaja tatimore

Ju duhet të dini se;

- ligji mund të parasheh sanksione, ndëshkime dhe/ose imponimin e interesit;
- ligji mund t'i parasheh Administratës Tatimore instrumentet për mbledhje dhe zbatim;
- evazoni tatimor dhe shkeljet mund të implikojnë shkelje kriminale dhe në raste më serioze mund të ndërmerren veprime persekutive .

Ju duhet të dini se sistemi ynë i ndëshkimeve tatimore siguron sanksione:

- *Nëse dështoni të regjistroni deklaratën tatimore;*
- *Nëse dështoni të paguani obligimin tatimor;*
- *Nëse nëndeklaroni shumën e caktuar të obligimit tatimor apo mbideklaroni shumën e caktuar të kreditimit tatimor;*
- *Nëse dështoni të krijoni, mbani dhe siguron shënimet;*
- *Nëse dështoni të plotësoni një deklaratë informatave;*
- *Nëse dështoni të mbani në burim, paguani apo mbani menjëherë tatimet;*
- *Nëse kryeni shkelje të TVSH-së;*
- *Nëse do të keni në posedim mallra pa origjinë.*

Barra tatimore ne pronën tuaj rezulton në shumën e barabartë me borxhi tuaj tatimor dhe, nëse refuzoni të paguani tatimin e vlerësuar brenda 10 ditëve pas dërgimit të njoftim -vlerësimit, ne mund të sanksionojmë pronën tuaj, përveç për pagesat e përkujdesjes së fëmijës dhe asistencës sociale, veshje themelore, ushqimin themelor, orenditë dhe gjërat personale.

Për më shumë informata

Nëse keni ndonjë pyetje lidhur me tatimin tuaj, ne japim disa mënyra për ju për të kërkuar informata nga ne:

Web: www.atk-ks.org

E-mail: info@atk-ks.org ;
standardet.profesionale@atk-ks.org

Fax: 038 / 200 25 007

Llojet e informatave:

- **personale** 038 / 200 250 46
- **biznesore** 038 / 200 250 17
- **kontributet** 038 / 200 255 19

Numrat telefonik të Zyrave Regjionale:	
Prishtinë	038/ 200 255 17
Prizren	029/ 214 963
Pejë	039/ 433 927
Gjilan	0280/ 32 967
Mitrovicë	028/ 530 059
Ferizaj	0290/ 320 387
Gjakovë	0390/ 330 021

Reagime lidhur me Statutin

Nëse keni pyetje apo komente lidhur me këtë statut ju mund të na shkruani në adresën e më poshtme elektronike:

e-mail: info@atk-ks.org

ORGANIZIMI TERRITORIAL SIPAS ATK-së



LEGJENDA

- Prishtina 1
- Prishtina 2
- Mitrovicë
- Ferizaj
- Gjilan
- Pejë
- Prizren
- Gjakovë
- Kufiri ndërmjet regioneve
- Kufiri ndërmjet komunave